



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.11.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.11.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i rrugëve me zhavor “ , Nr. i prokurimit- 632-21-5766-5-2-1, nxjerr:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM “ , e dt.01.11.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sanimi i rrugëve me zhavor “ , Nr. i prokurimit- 632-21-5766-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-21-110-521, kundër NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 26.10.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , e publikuar me datë: 26.10.2021;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sanimi i rrugëve me zhavor “ , Nr. i prokurimit- 632-21-5766-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-21-110-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.11.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

-Pretendimi juaj se ne kemi shpërblyer me kontratë Operatorin ekonomik me çmim më të lartë, nuk qëndron, sepse ne ju kemi kërkuar Juve sqarime shtesë për çmim jo normalisht të ulët për pozicionet 1,2,4,6,7,8,9, (9.1, 9.2, 9.3), 10 dhe 11, dhe pozicioni 3 me çmim shumë të lartë, dhe përgjigjet e juaj nuk ishin bindëse për Autoritetin kontraktues, prandaj në këtë pikë pretendimi juaj është i pabazuar;

- -Pretendimi juaj se Operatori ekonomik Berisha Company, ka prezantuar makinë ngarkuese (Buldozher) me peshë totale mbi 10t me rrota e jo me zinxhir, është i pabazuar sepse kjo nuk është kërkuar në Njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siq janë a.)1 eskavatorë ( makineri me strukturë rrotulluese ) me peshë totale mbi 10t, b) 2 kamiona me konstruksion-ndërtim kiper (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) me peshë totale mbi 10t, c.) 1 Makinë ngarkuese (Buldozher) me peshë totale mbi 10t d). 2 cilindra apo rula ngjeshës deri 10 t, e). 1 grejder

Lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjell dëshmi njëjërën prej këtyre dokumentave kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen (kopje)

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunë

**z.Faton Gutaj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

